



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:021522  
Datë: 26.02.2024  
Numri i dokumentit: 05372197

**C. nr. 400/2022**

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.K. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. K.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, me objekt të padisë kompensimi i pagës jubilarë, vlera e kontestit 391.23 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 26.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I.** APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses Sh.K. nga Prizreni, DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditëses në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar, për 20 vite përvojë pune, ti paguaj shumën e përgjithshme prej 315.75 euro apo 75 % të një pagë bazë (vlera e pagës bazë 421.00 euro), me kamat ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë me datë 03.02.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- II.** DETYROHET e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- III.** REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 391.23 euro, në emër të shpërblimit jubilar refuzohet e pa bazuar

**A r s y e t i m**

Paditësja Sh.K. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj av. K.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me datën 03.02.2022, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e pagave jubilarë, vlera e kontestit 391.23 euro.

I autorizuari i paditëses, në padi ka theksuar se paditësja është mësimdhënëse në SHFMU "Dëshmorët e Zhurit" në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit dhe e njejtja vazhdon të punojë edhe sot e kësaj dite dhe të njejtës i takon kompensimi i viteve jubilarë, ashtu siq parashihet me nenin 35 par.8 të kontratës kolektive të arsimit në Kosovë dhe atë në lartësi prej 75% të një page bazë që ka arritur 20 vite përvojë pune. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Ka theksuar se përfitues të beneficioneve që rrjedhin

nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm antarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-u, ndërsa paditësja nuk ka ofruar ndonjë provë që jështë anëtare e sindikatës. Paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të saj, pa paraqitur prova se i ka kaluar procedurat administrative, sepse nuk ka paraqitur kërkesë për kompensim pranë DKA në Prizren dhe nuk ka ushtruar ankesë në Inspektoratin e Punës, ashtu siç parashihet me Ligjin e Punës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.07/L-001. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditëses është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit.

Gjykata përmes vërtetimit me numë të protokollit 42/20 të datës 13.01.2020, të lëshuara nga ana e drejtorit të SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, vërtetoi faktin se paditësi Sh.K. është e punësuar pranë të paditurës si mësimdhënëse, dhe ka 21 vite përvojë pune, ndërsa paga bruto e saj është në lartësi prej 521.64 euro, ndërsa paga neto është në lartësi prej 465.86 euro.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj pasi ky vërtetim është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, gjykata i’a fali besimin e plotë, si prova me të cilën vërtetohet fakti lidhur me përvojën e punës për paditëses dhe pagën mujore të tyre, pasi paditësja Sh.K. i ka gjithësej 21 vite përvojë pune dhe paga neto e saj është 465.86 euro.

Sipas nenit 4 par. 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (LP), në mënyrë decidive përcaktohet se “*Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj*”. Po ashtu, në nenin 90 par. 5 të LP-së, theksohet që “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*”. Pastaj, në bazë të nenit 78 të LP-së, parashihet e drejta e të punësuarit që të kërkoj nga punëdhënësi për realizim të ndonjë të drejte dhe punëdhënësi është i obliguar që të vendos lidhur me një kërkesë të tillë. Në vazhdim, me nenin 79 të Ligjit të Punës, përcaktohet e drejta e të punësuarit që të kërkoj mbrojtje gjyqësore në Gjykatë Kompetente lidhur me vendimin apo mos veprimin e punëdhënësit lidhur me ndonjë kërkesë së të punësuarit.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), me nr. të njësisë 01B, nr. prot.2056, të datës 18.04.2017, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017.

Me nenin 35 par. 8.3, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK) është paraparë se “*Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: 8.1 për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë. 8.2 për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë. 8.3 për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë. 8.4 për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë*”. Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, për pjesën aprovuese si në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*” dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses Sh.K. nga Prizreni, për këtë pjesë është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e nenit 35 par. 8 të Kontratës Kolektive të Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ku pjesën tjetër të kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 391.23 euro në emër të shpërblimit jubilar për paditësen, e refuzoi të pa bazuar, kjo pasi që nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës gjykata konstatoi faktin se paditësja është mësimdhënëse dhe paga bazë për mësimdhënësit në Republikën e Kosovës është në lartësi prej 421.00 euro dhe jo në lartësinë e kërkuar e të refuzuar.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (03.02.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Për pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi konform nenit 449, 452.2 dhe 453.2 të LPK-së, si dhe në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve, në të cilat janë përfshirë, përpilimi i padisë në shumë prej në shumën prej 104,00 euro dhe taksës gjyqësore shumë prej 20.00 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
C.nr.400/2022, datë 26.02.2024

G j y q t a r i

Atdhe Berisha

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.